



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.11.2018, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja - kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit datë 07.11.2018.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr.1 të marrëveshjes së huas të datës 31.12.2012 ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit, ratifikuar me ligjin nr.103/2013”, nismë e Këshillit të Ministrave. *(Komision për dhënie mendimi)*
3. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, nismë e deputetit Alket Hyseni. *(Komision përgjegjës)*
4. Njoftimi mbi raportin e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” për procesin e ngritjes së Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Sistemin e Drejtësisë (KPESD), në zbatim të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Xhemal Qefalia.

**Mungojnë:**

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka dhe Tom Doshi.

**Të ftuar:**

Dorina Çinari - Zëvendësministre e Infrastrukturës dhe Energjisë

Agim Bregasi – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Fatmir Elezi – Inxhinier në KESH

Anisa Pina - Specialiste

Aldo Xherahu – Fotograf

Brikena Jazxhi – përfaqësuese e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Periand Tetam - Drejtor i Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë

Artur Metani – Avokat i Shtetit

Geraldina Prodani - Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Rene van Veen - ekspert ndërkombëtar i EURALIUS-it

Antuen Skënderi - eksperte e lartë vendase e EURALIUS-it

## HAPET MBLEDHJA

**Ulsi Manja** – Përshëndetje!

Sot në rendin e ditës kemi 4 çështje.

Së pari, miratimin e procesverbalit të mbledhjes së komisionit datë 07.11.2018.

Së dyti, shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 1 të marrëveshjes së huas të datës 31.12.2012 ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit, ratifikuar me ligjin nr. 103/2013”, nismë e Këshillit të Ministrave.

Së treti, shqyrtimin nen për nen të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, nismë e deputetit Alekt Hyseni.

Së katërti, njoftimin mbi raportin e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” për procesin e ngritjes së Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Sistemin e Drejtësisë (KPESD), në zbatim të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Vazhdojmë me çështjen e parë të rendit të ditës, me miratimin e procesverbalit.

A ka vërejtje për procesverbalin? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës, me shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 1 të marrëveshjes së huas të datës 31.12.2012 ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit, ratifikuar me ligjin nr. 103/2013”, nismë e Këshillit të Ministrave.

Nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë kanë konfirmuar pjesëmarrjen zonja Dorina Çinari, zëvendësministre, zoti Agim Bregasi, drejtor, zoti Fatmir Elezi, Inxhinier në KESH dhe zonja Anisa Pina, specialiste.

Mirë se keni ardhur!

Ju lutem, shkurtimisht, na bëni një prezantim të kësaj marrëveshjeje për kolegët dhe më pas fjalën do t'ia kaloj relatorit, zotit Leka.

Urdhëroni, zonja Çinari!

**Dorina Çinari** - Faleminderit, zoti kryetar!

Mirëmëngjesi të gjithëve!

Ne sot kemi sjellë për ju projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 1 të marrëveshjes së huas të datës 31.12.2012 ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim BERZH për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit, ratifikuar me ligjin nr. 103/2013”, nismë e Këshillit të Ministrave. Marrëveshja ndryshuese konsiston në përdorimin e fondeve të kursyera nga marrëveshja e kredisë, e ratifikuar me ligjin nr. 103/2013. Marrëveshja bazë, në shumën 12,7 milionë euro, parashikonte investimin në rehabilitimin e digës së hidrocentralit të Komanit. Ky aktivitet është realizuar plotësisht dhe sipas standardeve ndërkombëtare.

Rehabilitimi i digës së hidrocentralit të Komanit është realizuar duke u financuar nga marrëveshja e kredisë vetëm me 6,58 milionë euro. Pjesa tjetër e marrëveshjes së huas është e lirë dhe do të shërbejë për rehabilitimin e portave të shkarkimit të hidrocentralit të Komanit. Ky financim do t'i shtohet fondit prej 12 milionë eurosh të Bankës Botërore, sipas marrëveshjes së huas për këtë qëllim, ratifikuar me ligjin nr. 61/2018 të datës 20 shtator 2018.

Pas miratimit të marrëveshjes së Bankës Botërore në shumën 12 milionë euro, projekti për rehabilitimin e portave të shkarkimit të HEC-it të Komanit dhe të Fierzës nuk zbatohet dot, pasi bordi i drejtorëve ekzekutivë të Bankës Botërore gjatë negociimit për shumën 12 milionë vendosi dy kushte: miratimin nga parlamenti shqiptar të marrëveshjes së huas për shumën 12 milionë euro, publikimi në Fletoren Zyrtare dhe bërjen efektive të fondeve të mbetura në shumën 6,12 milionë euro nga marrëveshja bazë e BERZH-it, për të cilën kërkohet kjo marrëveshje ndryshuese.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Ju lutem, mbani pak qetësi të mbarojë zonja zëvendësministre, sepse pastaj humbet edhe sensi i pyetjeve dhe diskutimeve.

**Dorina Çinari** – Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje ndryshuese kërkohet përdorimi...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Ju lutem, mund të vazhdoni!

**Dorina Çinari** – Sipas marrëveshjes ndryshuese nr. 1, kërkohet ndryshimi i afatit të marrëveshjes së kredisë deri në vitin 2021, shtimi i afatit të projektit, ndryshimi i destinacionit

të financimit, sipas aktiviteteve shtesë, dhe mundësisht aktivizimi i ligjit menjëherë, sepse ka nevojë që të fillojë projekti menjëherë.

A keni pyetje?

**Ulsi Manja** - Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Leka si relator!

**Edmond Leka** – Faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji ka si qëllim ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 1 të marrëveshjes së huas të datës 31.12.2012 ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit. Amendimi parashikon përdorimin e fondeve të mbetura pa u përdorur nga kredia e akorduar për rehabilitimin e portave të shkarkimit dhe remontit në hidrocentralin e Komanit, si një bashkëfinancim me Bankën Botërore. Ky aktivitet nuk ka qenë i përfshirë në marrëveshjen bazë. Amendimi i propozuar nuk cenon objektivin kryesor të programit të sigurisë së digave. Kam edhe një propozim tjetër, por kur të vijmë te votimi nën për nen, do ta bëj ose, në qoftë se doni, mund ta bëj edhe tani.

**Ulsi Manja** – Jo, kur të vijmë te neni përkatës, mund ta bëni propozimin.

Faleminderit, zoti Leka!

A ka pyetje nga kolegët?

Urdhëroni, zoti Fino!

**Bashkim Fino** – Kam një pyetje, sepse në relacion thuhet, madje edhe zëvendësministrja e tha shumë saktë se gjatë zbatimit të projektit fillestar kanë ngelur pa përdorur 6 milionë e 128 mijë euro, ndërkohë ne kërkojmë një kredi tjetër nga BERZH-i rreth 12 milionë e 700 mijë euro, apo jo? Kështu thotë këtu?

*(Diskutim epa mikrofon)*

Pse mendoni se do të ketë investime shtesë kur thoni se këtë 6 milionëshin do ta përdorni për investime shtesë në qoftë se nuk ka një projekt të rregullt për rehabilitimin digës? Ju parashikoni që mund të ketë investime shtesë, ndërkohë që janë bërë projekte dhe projekti është korrekt.

**Ulsi Manja** - Kush do të përgjigjet nga ministria?

Urdhëroni, zoti Bregasi!

**Agim Bregasi** – 12,7-milionëshi, që është miratuar në vitin 2012 dhe ka hyrë në fuqi në vitin 2013, parashikonte një sërë operacionesh për rritjen e sigurinë së digave. Këto punime që janë bërë, sepse kanë qenë punime të maskuara, nuk dihen saktësisht, por edhe projekti është zbatuar, kanë sjellë mospërdorimin e 6 milionë e 128 mijë eurove. Tani para dy muajve

miratuam një kredi prej 12 milionësh që jepte Banka Botërore për rehabilitimin e portave të remontit dhe të punës në HEC-in e Fierzës dhe në HEC-in e Komanit. Nga preventivi që është bërë ato 12 milionë nuk mjaftonin, prandaj Banka Botërore ka vënë edhe një kusht që unë nuk i lëvroi këto 12 milionë në qoftë se nuk miratohet edhe ky 6 milionë e 128 mijë, që po kërkojmë sot.

*(Ndërhyje pa mikrofon)*

Jo, i ndërruam destinacionin, sepse ato kanë qenë për gjëra të tjera, ndërkohë ato kishin përfunduar, ashtu siç thuhet edhe në relacion, janë mbyllur 100% si punime me cilësi e të tjera. Pra, qëllimi i këtij projektligji, që ne kemi sjellë është ndërrimi i destinacionit të këtyre 6 milionëve që janë miratuar në vitin 2012, dhe shtyrja e afatit. Pra, nga ky projektligj kërkohen këto dy pika. Ajo që përmendi edhe zëvendësministrja, është se këtë e ka vënë kusht Banka Botërore, pa miratuar këtë, nuk na lëvron 12 milionët e tjera. Pra, kjo është ideja,

**Ulsi Manja** - Faleminderit, zoti Bregasi!

A ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

A ka diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në votimin në parim të këtij projektligji.

Kush është dakord në parim me këtë projektligj? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 1 të marrëveshjes së huas të datës 31.12.2012 ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit, ratifikuar me ligjin nr. 103/2013”.

Kalojmë në shqyrtimin dhe votimin nen për nen.

Relatori, zoti Leka.

Neni 1.

**Edmond Leka** – Për nenin 1 kam një propozim, meqenëse në tekstin e marrëveshjes për Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim përdoret shkurtimi BERZH, edhe në nenin 1, që është EBRD, të përdoret termi “BERZH”, pra edhe në titullin e ligjit të përdoret termi “BERZH”.

**Ulsi Manja** – Pra, të shqipërohet termi.

A jemi dakord me propozimin e zotit Leka? Dakord.

Neni 1

Kush është dakord me sugjerimin e zotit Leka? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 1.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 2.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit.

Kush është dakord në tërësi me projektligjit? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji.

Projektligji së bashku me raportin përkatës t'i përcillet komisionit përgjegjës dhe më pas seancës plenare për votim.

Këtu mbarojmë me pikën e dytë të rendit të ditës.

Faleminderit, zonja Çinari, së bashku me stafin!



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 20.11.2018, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja - kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, nismë e deputetit Alket Hyseni.

*(Komision përgjegjës)*

**Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Xhemal Qefalia.

**Mungojnë:**

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka dhe Tom Doshi.

**Të ftuar:**

Periand Tetam - Drejtor i Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë

Artur Metani - Avokat i Shtetit

Gelardina Prodani - Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Rene van Veen - ekspert ndërkombëtar i EURALIUS-it

Antuen Skënderi - eksperte e lartë vendase e EURALIUS-it



**Ulsi Manja** - Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës në shqyrtimin nen për nen të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, nismë e deputetit zotit Alket Hyseni. Komision ynë është komision përgjegjës dhe relatore është zonja Klotilda Bushka.

Nga Ministria e Drejtësisë kanë konfirmuar pjesëmarrjen zoti Perianand Teta, drejtor i Kodifikimit, nga Avokatura e Shtetit, zoti Artur Metani, nga misioni EURALIUS, zoti Rene van Veen, ekspert ndërkombëtar, dhe zonja Antuen Skenderi, eksperte e lartë vendase e EURALIUS-it.

Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë kemi të ftuar zonjën Geraldina Prodani, sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Do t’ju lutesha kolegëve që ta ndjekin në dinamikë ecurinë e të gjitha neneve, duke qenë se është një ligj relativisht voluminoz.

Përpara se të fillojmë në shqyrtimin dhe votimin nen për nen të këtij projektligji, dua të sjell në vëmendjen e kolegëve, por edhe të opinionit publik, se ligji “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar, është një nga projektligjet e paketës së dytë të reformës në drejtësi, të cilat po shqyrtohen në Komisionin e Ligjeve.

Për punën e mirë dua të falënderoj qoftë nismëtarin, zotin Hyseni, por edhe kolegen time Klotilda Bushka, si relatore, Avokaturën e Shtetit, misionin EURALIUS, Ministrinë e Drejtësisë, por edhe impenjimin e Ministrisë së Financave në lidhje me faturën financiare të këtij projektligji!

Sot jemi në një projekt të dakordësuar dhe ne do të votojmë nen për nen tekstin integral të projektligjit.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Vazhdojmë me shqyrtimin nen për nen të këtij projektligji.

Neni 1.

U lutem, përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë, Avokaturës së Shtetit dhe misionin EURALIUS, t’i mbajnë mikrofonat ndezur dhe për çdo nen të shprehen me mikrofon!

Neni 1.

Urdhëroni, zonja Bushka!

**Klotilda Bushka** - Dakord, sipas versionit integral në tabelën e paraqitur.

**Ministria e Drejtësisë** – Dakord.

**Artur Metani** – Dakord.

**Ulsi Manja** - A keni pyetje dhe komente për nenin 1?

Urdhëroni, zoti Fino!

**Bashkim Fino** – Në neni 1 togfjalëshi “në varësi të Ministrisë së Drejtësisë” të zëvendësohet me togfjalëshin “në varësi të Kryeministrisë”.

Zoti kryetar, sapo mbaruam projektbuxhetin e vitit 2019, e kaluam në parim dhe nen për nen, dhe meqenëse këto dy projektligje ditën e enjte do të kalojnë në seancë plenare, pra do të kalojnë paralelisht, në momentin që kalon projektligji “Për Avokatinë e Shtetit” dhe miratohet, do të ishte mirë, meqenëse kemi edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave këtu që ne si komision përgjegjës e kemi Avokaturën e Shtetit dhe që e dëgjuam nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, t’i bëjmë të mundur në relacionin Komisionet të Ekonomisë që ta ndajë buxhetin nga pjesa e Ministrisë së Drejtësisë dhe t’ia kalojë pjesës së Kryeministrisë, që në projektin e buxhetit të vitit 2019, që të jetë efektiv që nga 1 janari buxheti për Avokatinë e Shtetit, në qoftë se e miratojmë nenin 1. Më duket se është çështje teknike, por gjithsesi ne si komision ju propozojmë dhe në fund duhet ta thoni edhe ju këtë që të bëjmë një shtesë në relacionin tonë që i kemi bërë Komisionit të Ekonomisë për projektbuxhetin e vitit 2019, që pikërisht të bëjmë kalimin e këtyre fondeve nga ministria e Drejtësisë në Kryeministri.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

Ministria e Financave, a është e mundur teknikisht?

**Geraldina Prodani** – Po.

**Ulsi Manja** – Atëherë, e hedhim nenin 1 në votim, sipas tekstit integral, me sugjerimin e kolegut Fino.

Kush është dakord me nenin 1? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 1.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 2.

Neni 3. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 3.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 3.

Neni 4. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 4.

Neni 5. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 5.

Neni 6. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 6.

Neni 7. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 7.

Ju lutem, përfaqësuesve, aty ku keni për të bërë ndërhyrje dhe komente, shtypni mikrofonin dhe kërkoni fjalën!

Neni 8. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 8.

Neni 9. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 9.

Neni 10. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 10.

Neni 11. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 11.

Neni 12. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 12.

Neni 13. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 13.

Neni 14. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 14.

Neni 15.

Urdhëroni, zonja Bushka!

**Klotilda Bushka** – Në versionin e propozuar nga nismëtari neni 14 ka qenë i propozuar për çështjen e rregullimit të ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Europine të të Drejtave të Njeriut. Për efekt të riformulimeve të bëra në tekstin integral, kjo është shtuar si kre i veçantë, që do të dalë më pas. Kështu që, nga neni 14 do të kalojmë te neni 15.

**Ulsi Manja** - Neni 15. Kush është dakord me nenin 15? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 15.

Neni 16 “Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 16.

Urdhëroni, zoti Rene!

**Rene van Veen** – *(përkthen përkthyesi)* Çështja shkon te neni 19/4. Për vendimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Strasburgut është bërë një ndërhyrje për afatin tremujor, i cili duhet të mbetet vetëm për kompensimin e drejtë. Nuk e gjejmë me vend që ky afat tremujor të aplikohet për të gjitha vendimet e gjykatës, sepse ka disa vendime të cilat mund të kërkojnë

edhe ndërhyrje ne ligj ose në strukturë dhe kjo do të kërkonte një kohë më të gjatë se kaq. Pra, afati tremujor të shkojë vetëm për kompensimin e drejtë sipas vendimeve të Gjykatës Europiane të Strasburgut.

**Antuen Skenderi** – A të bëj një sqarim?

**Ulsi Manja** – Po, mund të vazhdoni të bëni një koment shtesë.

**Antuen Skenderi** – Si anëtare e grupit të punës, ne kemi qenë të dakordësuar në lidhje me standardin e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, i cili është 3 muaj, por si pjesë e këtij procesi legjislativ ne morëm edhe këshillimin e departamentit të ekzekutimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut për të qenë të sigurt për atë që propozonim. Ishte vetë ky departament që sugjeroi, nisur nga praktika e tyre, që ky afat tremujor të jetë vetëm për kompensimin e drejtë, sepse kjo është më realiste. Nuk besoj se është e nevojshme që për shtetin shqiptar të ketë masa më të shtrënguara, kur vetë ky sugjerim vjen nga departamenti i ekzekutimit.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Shumë faleminderit!

Fjalën e ka relatorja zonja Bushka.

**Klotilda Bushka** – Unë jam dakord. Kështu që sugjeroj që në nenin 16, i cili në vetvete shton disa nene, 19 e në vijim, për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Strasburgut, formulimi konkretisht i nenit 19/4 të bëhet: “Vendimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut për çështjet me objekt kompensimin e drejtë të ekzekutohen nga institucionet përkatëse sipas fushës së tyre të përgjegjësisë brenda 3 muajve nga momenti kur vendimi i Gjykatës merr formë të prerë”. Pra, bëhet fjalë vetëm për vendimet që kanë të bëjnë me kompensimin e drejtë.

Zoti kryetar, dua të përmend patjetër se i gjithë ky kre është i ri, i shtuar nga kontributi i EURALIUS-it, duke marrë në konsideratë edhe mendimin e departamentit përkatës të ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut si një detyrim për Shqipërinë, në mënyrë që të kemi mekanizma efektivë ligjorë për përmbushjen e detyrimeve që ne kemi nga qenia pjesë e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Jo vetëm kaq, por në këtë kapitull, të nderuar kolegë, kemi shtuar edhe një nen të fundit, i cili rregullon edhe marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me parlamentin për sa i takon ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut si një detyrim që na lind nga dy rezoluta të Këshillit të Europës, Asambleja Parlamentare, që flet për rolin mbikëqyrës që duhet të ketë Kuvendi në zbatimin e këtyre vendimeve. Kështu që unë i përgëzoj dhe i mendoj si dy momente, të cilat duhet të parashikohen si risi në këtë pjesë të legjislationit, i cili përmbush jo

vetëm detyrimet ndërkombëtare që ka Shqipëria në këtë drejtim, por edhe realizon në mënyrë efektive të drejtat e shtetasve.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Shumë faleminderit, zonja Bushka!

Kush është dakord me nenin 16 me sugjerimet e bëra nga EURALIUS dhe me riformulimin e pikës që bëri kolegja Bushka? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 16.

Kalojmë te neni 17 “Kushtet për t’u emëruar Avokat i Shtetit”. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 18. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 19. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 20. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 21. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 22. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Te neni 22 janë shkruar në mënyrë të detajuar lirimi dhe shkarkimi nga detyra. A duhet t’i shkruajmë të gjitha rastet? A ka raste të tjera për shkarkimin e Avokatit të Shtetit? Mënyra si është bërë këtu tregon se vetëm me këto pika mund të shkarkohesh, por mund të ketë edhe të tjera. Mos duhet të lëmë ndonjë hapësirë. Në fund të fundit, kjo është kompetence e Kryeministrit dhe e Këshillit të Ministrave. Nuk prish punë edhe po të jetë kështu, por duket shumë si rregullore.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

Po, zonja Hysi, një koment.

**Vasilika Hysi** – Në fakt, komentin do ta bëjë besoj edhe relatorja, por çështjen e zotit Fino ne e kemi diskutuar edhe në një sërë projektligjesh të tjera të diskutuara në komision lidhur me rregullat për emërimin dhe shkarkimin, rastet e masave disiplinore, procedurat. Ka një orientim dhe na është bërë gjithmonë një sugjerim nga misioni EURALIUS, por edhe nga misionet e tjera që kanë asistuar në hartimin e projektligjeve, të cilat kanë të bëjnë me emërimet

dhe me shkarkimet, dhe është thënë se në ligj duhet thënë në mënyrë taksative, të detajuar e transparente se cilat janë shkeljet disiplinore. Madje, ato duhen ndarë sipas shkallës së rëndesës së tyre dhe masat disiplinore që i shoqërojnë ato. Besoj se ky është një orientim që deri më sot nuk e kemi pasur në pjesën më të madhe të ligjeve, i kemi lënë shumë evazive, për rrjedhojë ka pasur subjektivizëm në interpretimin nëse përben një veprim ose mosveprim, një shkak për t'u pushuar. Kjo është edhe në procesin e rregullt ligjor dhe për të gjithë procedurën e mëtejshme.

**Ulsi Manja** – Shumë faleminderit!

Kush është dakord me nenin 22? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 23, kreu 6/1 “Të drejtat dhe privilegjet e Avokatit të Shtetit”. Kush është dakord me nenin 23? Kundër? 1 kundër . Abstenim? Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Fjalën e ka zoti Fino për të shpjeguar votën.

**Bashkim Fino** – Nuk e kuptoj. Kur vjen puna te këto statutet, ato duhet të shikohen vërtet me kujdes kur të kalojnë ligjet. Dua të bëj një pyetje shumë të thjeshtë: çfarë thotë neni 26/2 në funksion të kësaj? Neni 26/2/a thotë: “Me kërkesën e tyre, me miratim të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, shërbejnë për një afat deri në 3 vjet në strukturat juridiko-profesionale të Kryeministrisë, të Ministrisë së Drejtësisë, të administratës të Këshillit të Lartë Gjyqësore etj., ose drejtori i Shkollës së Magjistraturës etj”. Më pas po në pikën 2 të këtij neni thuhet: “Kur të kthehen këta, pasi të punojnë 3 vjet atje, pagën e marrin atje ku shkojnë, në rast se pozicioni i mëparshëm është i plotësuar, përfundimisht i jepet një pozicion paralel me të njëjtin nivel”. Pyetja që kam unë është: në qoftë se një punonjës jep kontribut në një institucion tjetër për 3 vjet, pse duhet t’ia ruajmë vendin e punës tek Avokatura e Shtetit, nëse kthehet pas 3 vjetve? Këtë nuk e kuptoj. Në qoftë se ai shkon me një detyrë tjetër për të bërë punën në Kryeministri, në Ministrinë e Drejtësisë, në Këshillin e Lartë të Drejtësisë ose edhe drejtor i Shkollës së Magjistraturës 3 vjet, pra nga Avokatura e Shtetit shkoi bëri një detyrë tjetër dhe për shumë arsye ka pranuar edhe vete, është marrë vendimi i qeverisë, urdhri i Kryeministrit, ka shkuar në një detyrë tjetër dhe tani i themi: “Meqenëse shkove, të shpumë ty me zor, se kështu lexohet, ai thotë pas 3 vjetve: “Stop tani, se unë dua të kthehem në vendin tim të mëparshëm”. Ky lloj statusi më duket jokorrekt. Nëse ikën nga Avokatura e Shtetit dhe fillon një punë tjetër, ta gëzosh punën tjetër! Kjo nuk do të thotë se të gjithë që ikin me dëshirën e tyre, me dëshirën e Kryeministrit apo të drejtuesve të tjerë të institucioneve për një detyrë tjetër, mbase më pak të rëndësishme apo edhe të rëndësishme, se nuk di ta krahasoj, t’u themi që pas

3 vjetësh kanë të drejtën që të kthehen përsëri në të njëjtin vend pune ku kanë qenë. Nuk e kuptoj këtë gjë. Asnjërit nuk i luhet vendi i punës siç po e bëni ju te statusi i nenit 26.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

Ju lutem, zonja Bushka, një sqarim, edhe pse ne e kemi votuar nenin 23. Rasti i zotit Fino ishte shpjegim vote.

**Klotilda Bushka** – Ka nevojë për sqarim dhe është një pyetje e drejtë. Me ndryshimet që i bëjmë ligjit për Avokaturën e Shtetit, kemi përputhur gjithçka që kanë miratuar ligjet aktuale në fuqi të reformës në drejtësi, kryesisht ligji për organet e qeverisjes dhe ligji për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në të dyja ligjet kemi parashikime që ata, të cilët do të jenë avokatë shteti nga momenti që do të plotësohet kursi i trajnimit fillestar nga Shkolla e Magjistraturës, do të jenë patjetër juristët që do të bëjnë një shkollë dyvjeçare pranë Shkollës së Magjistraturës, pasi të kenë një eksperiencë trevjeçare në një institucion publik ose në marrëdhënie pune. Kemi të bëjmë me individë profesionistë, të cilët, kur të fillojnë të punojnë tek Avokatura e Shtetit, pasi të kenë mbaruar Shkollën e Magjistraturës, do të kenë një cilësi profesionale, e cila është e tillë që ndihmon në rritjen e performancës së institucionit shtetëror. Për këtë arsye, me qëllim që ky lloj grupi juristësh të formuar të kenë mundësi të japin kontribut edhe në institucione të tjera të administratës shtetërore, por të kenë një lloj incentive që të shkojnë të punojnë 3 vjet të paktën në një institucion, me të drejtën që të kthehen mbrapsht në vendin e Avokaturës së Shtetit, që është një pozicion karriere. Kjo do ta mundësojë tërheqjen e tyre drejt pranimin të pozicioneve për një periudhë të përkohshme edhe në institucione të tjera. Këtu flasim për struktura juridiko-profesionale, nuk flasim për pozicione drejtuese, pra në rolin e këshilltarëve, të specialistëve që merren kryesisht me punë që kanë të bëjnë me performancën më të mirë të institucionit. Në këtë kuadër i është lënë kjo e drejtë. Ruajtja e pozicionit të punës është në një farë mënyre një privilegj që u jepet një grupi juristësh që, kur të dalin nga Shkolla e Magjistraturës jo vetëm të shërbejnë tek Avokatura e Shtetit, por të kenë mundësi të japin kontribut edhe në institucione të tjera shtetërore. Kjo është logjika.

**Bashkim Fino** – Mua më duket diskriminuese kjo. Domethënë, kjo pjesë e elitës, siç tha zonja Bushka, të juristëve që japin ndihmë në institucione të tjera duhet t'u garantohet patjetër që pas 3 vjetve të kthehen në vendin e punës së mëparshme. Nuk e kanë profesione të tjera një status të tillë në të gjitha ligjet që ne kemi kaluar. Për shembull, ekonomistët, doktorët dhe inxhinierët nuk e kanë. Kaq pak juristë paskemi ne që kjo bërthamë e vogël, këta njerëz që janë kaq të talentuar, të cilët do të shkojnë të punojnë 3 vjet në një institucion tjetër për ta ndihmuar atë institucionin tjetër, se nuk është në rregull ai, kanë të drejtë të rikthehen dhe ta

gjejnë hapur derën të Avokatisë së Shtetit, ndërkohë që të gjitha funksionet e tjera nuk e kanë një gjë të tillë! Unë jam totalisht kundër.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino.

Zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, e kuptoj shqetësimin e kolegut Fino, por mbështes fort argumentet që dha kolegja Bushka. Për informacion, edhe në ligje të tjera të kaluara në Komisionin e Ligjeve ne kemi parashikuar që magistratë, pra gjyqtarët dhe prokurorët për një periudhë të caktuar mund të punojnë në disa sektorë që lidhen me drejtësinë. Në Drejtorinë e Kodifikimit, ku kemi nevojë për juristë profesionistë që kanë përvojë, ose në KLD; edhe tek Inspektori i Drejtësisë ne kemi pasur magistratë të cilët kanë punuar përkohësisht dhe pas një periudhe kohë janë rikthyer. Edhe në ligjin e ri të reformës në drejtësi e kemi parashikuar. Shqetësimi që ju ngrini pse pikërisht vetëm në fushën e ligjit dhe jo në fusha të tjera, është një çështje që, nëse do të keni ndonjë ligj në fusha të caktuara, ku ka mungesë të profesionistëve për të rritur kapacitetet, ne mund ta parashikojmë.

Unë kam një pyetje për relatore, por edhe për avokatin. Në rast se një avokat i shtetit, jo avokati vetë, por persona të tjerë, punojnë si këshilltarë në Gjykatën e Lartë, a është parashikuar në projektligj konflikti i interesit? Pra, në qoftë se ai ka qenë përfaqësues i çështjes si Avokat i Shtetit dhe më pas shkon e ofron këshillim në Gjykatën e Lartë, besoj se këtu duhet vepronjë rregullat e shmangies së konfliktit të interesit.

**Klotilda Bushka** – Ligji për Avokaturën e Shtetit jo vetëm për rastet konkrete që përmendi zonja Hysi me të drejtë, sepse janë raste tipike të konfliktit të interesit, siç është puna e këshilltarit të Gjykatës së Lartë që punon avokat shteti, por për këdo avokat shteti që është në detyrë dhe ai që do të rekrutohet, nëse është në kushtet e konfliktit të interesit të dukshëm, të mundshëm apo rast pas rasti në ligj, parashikohet një dispozitë e cila e trajton rastin sipas legjislacionit në fuqi për konfliktin e interesit.

**Ulsi Manja** – Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Duke falënderuar të dyja zonjat e nderuara në krahun tënd si relatore për këtë çështje, pyetja që unë kam dhe diskutimi që unë bëra është ky: zonja Hysi, zonja Bushka, në rast se nga Avokatura e Shteti avokatë të thjeshtë apo avokati i përgjithshëm ikin me dëshirën e tyre në një nga këto institucionet që parashikon neni 26, unë mendoj se nuk duhet ta kenë të drejtën që ta gjejnë derën e hapur të kthimit pas 3 vjetësh. Në qoftë se nga Avokatura e Shtetit për ato arsye që thatë ju, dhe jam plotësisht dakord për atë individë të cilët vërtet mund ta na duhen në Drejtorinë e Kodifikimit, në Shkollën e Magjistraturës etj., me porosi dhe



me urdhër të Kryeministrit, se tani janë në varësi të tij apo jo, u thonë do të shkoni atje, se atje kemi më shumë nevojë dhe na duhet të na ndihmoni, jam plotësisht dakord të respektohet neni 26. Ai jurist nuk ikën me dëshirën e tij, por me një urdhër të eprorit për të dhënë një ndihmë në një institucion tjetër përsëri juridik, shumë të rëndësishëm që i duhet Kryeministrit apo Avokatit të Shtetit dhe teorikisht dhe praktikisht duhet që pas 3 vjetëve të rikthehen përsëri aty sepse, kur ka ikur, ka ikur pa dëshirën, por sepse i thanë që duhet të shkonte atje. Vetëm atëherë mund të ketë vlerë neni 26. Neni 26 nuk duhet të ketë vlerë për të gjithë, në qoftë se nuk e dërgon ti, por një avokat shkon vetë, i cili pas tre vjetësh thotë: do të kthehem në detyrën time, sepse ma mundëson ligji i Avokaturës së Shtetit, kjo është e gabuar, zoti kryetar.

Në qoftë se duam ta rregullojmë, unë bëj një propozim: “Në rastet kur nga Avokatia e Shtetit me urdhër të Kryeministrit shkon në një institucion tjetër, nga këto institucionet që keni listuar te neni 26, jam plotësisht dakord të qëndrojë neni 26, pra për të gjetur atë vend vakant apo një vend paralel për t’u rikthyer. Në të kundërt, nëse ikën vetë, jam kundër vlerësimit që u bëni disa juristëve për t’u rikthyer dhe për ta gjetur vendin gati tek Avokatia e Shtetit. Dua të di mendimin e zonjës Hysi, se do të më ndihmojë shumë. Dua të më thotë tani nëse është dakord me këtë sugjerim që bëra unë apo nuk është.

**Ulsi Manja** – Zonja Hysi e dha mendimin e saj, por po sqaron zoti Shameti.

Zoti Fino, Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar zoti Hyseni.

**Alket Hyseni** – Edhe me lejen e zotit Fino që të jap një shpjegim. Në parim zoti Fino ka të drejtë, por kjo është zgjidhur, sepse janë dy elemente: me kërkesën e tyre dhe me miratimin e Avokatit të Përgjithshëm. Pra, është Avokati i Përgjithshëm filtri që do të shikojë nëse kalimi i një avokati nga funksioni i tij në një detyrë tjetër shtetërore është i domosdoshëm atje apo është më e rëndësishme të qëndrojë në atë pozicion.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Zoti Hyseni, shumë faleminderit!

Ishte me rëndësi sqarimi.

Kalojmë te neni 27.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Zoti Fino, ne e kemi votuar nenin 26 me votën tuaj kundër.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të gjitha shpjegimet që mund të marrësh nga zonja Bushka, zonja Hysi dhe zoti Hyseni, nuk besoj se...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ja, do ta kthejë përgjigjen zonja Hysi, por problemi është se nenin 26 e votuam.

**Vasilika Hysi** – Zoti Fino, faleminderit për pyetjen!

Në fakt, nuk dua të përsëris atë që me të drejtë zoti Hyseni tha, në germën “a” të nenit 26 pika 2, thuhet që Avokati i Shtetit nuk e humbet statusin e Avokatit të Shtetit me kërkesën e tyre dhe me miratim të avokatit. Pra, jo gjithmonë kur ka një dëshirë të Avokatit të Shtetit për të punuar në një institucion, patjetër ai do të shkojë.

Së dyti, rrethi i institucioneve, ku ai mund të ushtrojë aktivitetin e tij është strikt, i përcaktuar qartë. Janë struktura juridiko-profesionale, ku thuhet se edhe në cilat institucione mund të shkojë. Pra, ai mund shkojë në Ministrinë e Drejtësisë, por nuk mund të shkojë në një strukturë që nuk është juridiko-profesionale dhe e gjithë ideja është si të ligji i statusit të magistratit në Republikën e Shqipërisë. Janë disa sektorë në administratën publike, ku ne kemi nevojë për burime njerëzore të specializuara dhe, meqenëse kjo bëhet me miratim të Avokatit të Shtetit, mendoj se është vënë shumë mirë në balancë interesi publik dhe interesi individual i Avokatit të Shtetit.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Hysi!

Kalojmë te neni 24, i cili ndryshon nenin 27 “Pagat, shpërblimet dhe trajnimet”. A ka ndonjë koment për këtë nen?

**Bashkim Fino** – Janë disa nene 26, a do t’i marrim veç e veç këto apo i kalojmë nenit 26?

**Ulsi Manja** – Jo, kaluam nenin 23, i cili ndryshon kreun 6/1 dhe shton të gjitha nenet si më poshtë: 26/1, 26/2, 26/3, 26/4 deri te nenin 26/9.

Kush nuk ka ardhur për projektligjin është i lirë të largohet.

Zoti Fino, votuam nenin 23, i cili shton të gjitha këto nene. Ju propozoni që t’i votojmë nen për nen nenet që shtojnë nenin 23?

**Bashkim Fino** – Po. Atëherë, që të jemi korrektë, neni 23 ka nenin 26/1, që ne e kaluam, nenin 26/2, për të cilin bëra vërejtje, neni 26/3 “Ngritja në detyrë, ulja në detyrë, transferimi” e kaluam, nenin 26/4 “Ngritja profesionale”, nenin 26/5 “Dokumenti identifikimit”. Këto janë nene më vete dhe nuk mund t’i kalojmë kështu, neni 26/6, neni 26/7 “Koha e punës” kam një pyetje. Me ç’të drejtë ju si relatore keni vënë pikën 3, ku thoni:

1. “Avokati i Shtetit kohën javore dhe orarin e ka të njëjtë me punonjësit e administratës publike”.

2. Në rast nevojë, me urdhër të eprorit të drejtpërdrejtë, të Kryeministrit, ose Avokatit të Shtetit, Avokati i Shtetit është i detyruar të punojë edhe jashtë orarit në ditët e pushimit javor, festat zyrtare, kur dhe duhet kryer leja vjetore.

3. Avokati i Shtetit, i cili kryen detyrat e ngutshme edhe në ditët e pushimit vjetor ose në festat zyrtare, përfiton shtesë në pagë në masën 50% të pagës.

**Artur Metani** – E ka Kodi i Punës.

**Bashkim Fino** – Në qoftë se e ka Kodi i Punës unë jam i detyruar t'ju bëj vërejtje ju. Vëreni edhe 100% po të doni, por do të dëgjoni xhevahire. Në qoftë se e ka Kodi i Punës, nuk ke të drejtë ta vësh këtu në këtë ligj. Mund ta vini nenin që Avokati i Shtetit zbaton Kodin e Punës dhe aty e ka fitimin e 50%-it, nuk keni pse ta vini pikë më vetë që, në qoftë se punon në ditë pushimi, do të marrë 50 %. Kur punon ti, zotëri, që je deputet, a merr 50 % më shumë? Kur punon një mjek, apo një infermier, a merr 50 % më shumë? Kur punon cilido profesion, a merr 50 % më shumë? Jo, nuk marrin.

**Ulsi Manja**- Faleminderit, zoti Fino!

**Alket Hyseni** - Mendoj se një rregullim i tillë nuk është mirëfilltazi i rregulluar në Kodin e Punës dhe as në statusin e nëpunësit civil, as në ndonjë ligj specifik, por në një ligj të posaçëm. Po përpiqemi t'i japim Avokatit një status të merituar. Në rastin konkret ne nuk kemi kapërcyer asgjë që do të merrte, edhe pa bërë në këtë ligj. Avokatët, edhe sot, edhe dje, edhe para 10 vjetëve, që në themelim, që kanë punuar jashtë orarit, e kanë fituar këtë, por ne po sanksionojmë me një ligj të veçantë këto gjëra dhe mendoj të mos i lëvizim fare.

**Ulsi Manja**- Jam shumë dakord me sugjerimin, sepse çështjet e arbitrazhit zgjasin, mund të jetë edhe e shtunë, edhe e diel, prandaj është bërë ky përcaktim në këtë nen. Kështu që ne e kaluam nenin 23. Kalojmë te neni 24 “Pagat, shpërblimet dhe trajnimet”.

**Bashkim Fino**- A mund të bëj një sugjerim?

**Ulsi Manja**- Po.

**Bashkim Fino**- Zoti Kryetar, më duket se jam kritik, por me të drejtë, sepse jam lodhur shumë me projektbuxhetin dhe jam lodhur shumë edhe me tabelën e pagave që kemi diskutuar gjatë kësaj kohe. Unë vërej një tendencë që projektligjet e veçanta, të cilat vijnë këtu, ne mundohemi t'i kalojmë sa më shpejt dhe në to fusim edhe statutet e tyre. Pyetja ime është parimore: kur ne bëjmë një projektligj, si në rastin e Avokatit të Shtetit, si në rastin e organeve të pushtetit vendor, si në rastin e gjyqësorit e të tjera me radhë, a duhet të merremi me ligjin bazë organik të tyre, me statutet e tyre, kur me statutet e tyre mund të merret një ligj tjetër që ka qeveria? Pra, ne duhet të merremi me funksionimin dhe me procedurën sesi duhet të funksionojë një institucion me ligjin organik dhe ky është një ligj organik për Avokatin e Shtetit, për Avokatin e Popullit apo edhe për çdo ligj tjetër. Ne, me sa duket, merremi me 2-3 kapitujt e parë, me pjesën funksionale dhe procedurale, dhe shumë mirë bëjmë, e në fund i futim një kapitull, statusin e tyre. Te statusi i tyre vendosim nene shumë interesante, të cilat,

kur vjen puna për t'i diskutuar në projektbuxhet, apo kur vjen puna për t'i trajtuar në hierarkinë e pagave që kemi nga Presidenti i Republikës deri te nëpunësi më i thjeshtë, na lidh duart ligji që kemi kaluar dikur me status të veçantë. Këtë gjë po bëjmë edhe me Avokatin e Shtetit, por po përsërisim të njëjtat gabime që kemi bërë me çdo ligj organik, që unë jam kundër kësaj, për të kaluar statutet e tyre. Statuset e tyre do të kalojnë me ligj të veçantë të rregullimit të pagave, të ditëve të pushimit dhe të gjitha me radhë për të gjithë nëpunësit e lartë. Çfarë është Avokati i Shtetit? Nëpunës i lartë shtetëror. Sa veta ka Avokati i Shtetit? X veta, të miratuar në buxhetin e shtetit. Për 82 mijë veta, që ne miratojmë strukturën në buxhetin e shtetit, është edhe Avokati e Shtetit, i cili është në varësi të Kryeministrit me fond page e të gjitha me radhë. Pse ne duhet të kalojmë statute të tilla?

E bëra këtë diskutim përpara fillimit të trajtimit të nenit 24, sepse shikoj pagat, shpërblimet e të tjera me radhë, pasi po t'i hyj përlllogaritjes me këtë nen, nuk kam gjë personalisht, do të më rezultojë që, jo, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit ta ketë pagën kaq, por do të na dalë, me këtë llogaritje që keni këtu, me këtë çarje që keni bërë ju, që edhe avokatët, të cilët janë në varësi të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit do të kenë trajtime financiare më shumë nga zonja Bushka dhe më shumë nga ju si kryetar i Komisionit të Ligjeve. E pra unë do të them se përgjegjësia politike që keni ju, zoti kryetar, si kryetar i Komisionit të Ligjeve në një parlament legjitim të zgjedhur nga populli, është shumë herë më e madhe, politikisht, se një avokat i thjeshtë. Përgjegjësia e Presidentit, e Kryeministrit, juaja, e të gjithëve këtu, pa fyer asnjëri, është shumë herë më e madhe sesa e një avokati të thjeshtë. Kjo nuk më pengon mua të përmend pagën e një avokati të thjeshtë, sepse po të bëjmë një përlllogaritje, del më shumë sesa paga jote.

**Ulsi Manja-** Faleminderit, zoti Fino!

**Bashkim Fino-** E kam parimore, s`e kam personale...

**Ulsi Manja-** Kemi kaluar te neni 24.

**Bashkim Fino-** Kemi kaluar, por kjo nuk do të thotë ta kalojmë edhe këtë....

**Ulsi Manja-** Kush e do fjalën pas zotit Fino? Po, zonja Bushka.

*(Ndërhyrje pa mikrofoni)*

**Klotilda Bushka-** Zoti Fino në parim ka shumë të drejtë për të gjithë diskutimin që ka bërë. Në fakt, ka ardhur momenti, siç e kemi diskutuar edhe gjatë shqyrtimit në parim të ligjit të buxhetit të shtetit, që të rishikojmë edhe një herë gjithë sistemin tonë të pagave, në mënyrë që të vëmë në binarë sistemet e referimit, sepse tashmë kemi një piramidë, e cila nuk ekziston si e tillë.

Për ligjin aktual që jemi duke shqyrtuar, sa i takon zyrës së Avokatit të Shtetit jemi duke bërë ndryshime në ligjin ekzistues, i cili në vetvete kishte një nen për pagat dhe shpërblimet, por sot ndryshimet që ne i bëjmë ligjit lidhen me standardet që kërkohen nga reforma në drejtësi, e cila, nëse i referohemi “Strategjisë së reformës në drejtësi” dhe, konkretisht, shtyllës së profesioneve që duhet të rrisin standardet sa i takon përafrimit të performancës në të gjithë sistemin e drejtësisë, në objektivin 5 thuhet shumë qartë që një nga qëllimet e kësaj strategjie është ndryshimi i legjislacionit për riorganizimin e zyrës së Avokaturës së Shtetit, duke marrë në konsideratë vendosjen e kësaj zyre pranë Kryeministrit dhe parashikimin e një skeme të veçantë pagash në përputhje me kualifikimin e Avokatëve të Shtetit. Pra, është një detyrë, e cila ka mbetur për t’u realizuar si pasojë e reformës në drejtësi dhe, në këto kushte, duke qenë se varësia e zyrës së Avokatit të Shtetit vihet nën Kryeministrin, edhe skema e pagave, që propozohet në këtë projektligj, është e tillë me atë sistem referimi sipas legjislacionit aktual, ku paga referohet tek titullari i institucionit epror. Në këto kushte, ne kemi marrë edhe mendimin e Ministrisë së Financave dhe kemi arritur në këtë konkluzion, që, nëse do të duam të bëjmë rregullim të situatës që paraqet zoti Fino, do të jetë mirë që në të ardhmen Ministria e Financave dhe qeveria ta rishikojnë komplet legjislacionin e pagave, por nuk e zgjidhim dot me çdo ligj të veçantë. Tjetra, ndoshta nesër, në një të ardhme, Avokatura e Shtetit duhet të dalë si institucion më vete, që do të thotë të mos jetë institucion varësie, në mënyrë që të përmbushen më së miri objektivat e vëna nga strategjia e reformës në drejtësi. Faleminderit!

**Ulsi Manja-** Ju faleminderit!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem!

Marrim një përgjigje nga përfaqësuesja e Ministrisë së Financave, zonja Prodani.

**Geraldina Prodani-** Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, ne ndajmë të njëjtin shqetësim, ashtu sikurse ngriti deputeti Fino, për arsye sepse...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja-** Po, zonja Prodani.

**Geraldina Prodani-** Ne ndajmë të njëjtin shqetësim me deputetin Fino, jemi në të njëjtën linjë, edhe pse jemi të dakordësuar kundrejt koeficienteve që i meriton, por ne mendojmë se këtu nuk është vendi për t’u futur në ligj, ato duhet të jenë me vendim qeverie, apo në ligjin e hierarkisë së pagave, ku koeficientët të rrinë në të gjitha funksionet e

administratës shtetërore. Këtë mendim ka Ministria e Financave, të cilin e ka sjellë dhe depozituar edhe te ju.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja**- Faleminderit, zonja Prodani!

Po, zoti Çuçi.

**Bledar Çuçi**- Faleminderit, kryetar.

Në fakt, i bashkohem shqetësimit të kolegut Fino, i cili është një shqetësim që duhet marrë seriozisht dhe duhet trajtuar ashtu siç kemi rënë dakord edhe pas diskutimeve që bëmë për buxhetin. I gjithë legjislacioni që rregullon sistemin e pagave në Shqipëri duhet parë në tërësi. Edhe logjika që, meqenëse është në varësi të Kryeministrit, duhet të marrë 0.95 %, gati sa Kryeministri page, nuk qëndron, kur vetë ministri është pjesë e Këshillit të Ministrave dhe merr më pak sesa 0.95 % e Kryeministrit.

E dyta, edhe pagat, ashtu siç e tha zoti Fino, të avokatëve të Shtetit, por edhe të avokatëve në nivel vendor, po t'i bëjmë llogari, dalin në mos më shumë apo njësoj me pagën e deputetit. Jam dakord që nuk duhet të kemi diferenca të mëdha page, por mendoj që të mos jemi edhe kaq cinikë, që ne këtu të japim për gjithë sistemin, siç e bëri zoti Fino në diskutimet e buxhetit, gjithë sistemin e pagave, një piramidë me kokë poshtë, por duhet të fillojë sipas hierarkisë që e përcakton një ligj, i cili është në fuqi, që fillon me pagën e Presidentit dhe sipas hierarkisë të pozicioneve në funksionet publike të vijë deri poshtë, në nivel vendor.

Argumenti që ne duhet të kemi paga të larta, sepse duhet të incentivojmë profesionistë të mirë, në mënyrë që të kemi performancë të mirë në çështjet gjyqësore që lidhen me mbrojtjen e interesit të shtetit, mendoj se nuk zgjidhet në këtë formë, sepse prapë konkurrencën nuk e përballon dot me avokatin që ka përballë Avokati i Shtetit, por do të zgjidhen me formë tjetër, që për fat të mirë e kemi parashikuar në nenin më poshtë, duke e incentivuar me përqindje në bazë të suksesit në çështje të caktuara. Për mua kjo bën më shumë sens, në mënyrë që ne të lidhim suksesin për çdo çështje të çdo avokati që përballlet me çdo çështje konkrete gjyqësore, merr një përqindje për suksesin që ka në atë çështje. Kjo, për mendimin tim, është më e drejtë dhe, pa diskutim, që përfitimin do ta ketë avokati më i mirë, ku dallimi bëhet midis vetë performancës së vetë avokatëve, por mbi të gjitha nuk prishim hierarkinë e pagave, sepse kemi ndërtuar një piramidë me kokë poshtë. Sot që flasim në sistemin referues së pagës, kjo është një piramidë me kokë poshtë. Kështu që, unë them që pjesën e pagës duhet ta referojmë diku tjetër, e cila do t'i caktohet drejtpërdrejt strukturës së Avokatit të Shtetit, por duke ruajtur gjithmonë dhe duke zhvilluar më mirë sistemin e përqindjes përsuksesin e çështjeve të çdo

avokati për çdo çështje që ai mbron. K jo është gjëja më e drejtë që mund të bëjmë tani për tani sa i përket Avokatit të Shtetit. Faleminderit!

**Ulsi Manja-** Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Zoti kryetar, unë dua ta cilësoj se diskutimin nuk dua ta bëj me individë të caktuar, por me institucione, pavarësisht se këtu kemi prezent Avoaktin e Shtetit dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave. Më lejoni t’ju them që i kam shifrat në duar dhe do ta vazhdoj diskutimin aty ku e la zoti Çuçi, do të bëj edhe një diskutim pro tyre, përveç diskutimit kundër. Çfarë thotë neni 27? Ai thotë 0.95% të pagës së Kryeministrit. Sa është paga e kryeminsitrit? 228 mijë e 730 lekë herë 95%....

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Vasilika, dëgjo pak, sepse edhe ti e ke 73% më të lartë se ne, ndërkohë që ne e kemi 61% të Presidentit.

228,7 herë 95%, paga e Avokatit të Shtetit del 21.729 lekë. Paga e Avokatit të Shtetit në nivel qendror del 1 milion e 694 mijë lekë, ndërkohë që paga e ministres është 174,7 më e vogël se e Avokatit të Shtetit, ndërkohë që paga juaj, kryetar, është 156,7 më e vogël se e avokatëve të shtetit, ndërkohë që paga e kryetarit të zyrave vendore është 1 milion e gjysmë, aq sa e deputetit. Ti, kryetar, nga pikëpamja e pagës, vlerësohesh i barabartë me një kryetar zyre vendore, pasi nga pikëpamja politike je shumë herë më lart, je më lart edhe se Avokati i Shtetit, je në nivel me Kryeministrin. Në nenin më poshtë ne do ta kalojmë pikën ku thuhet: “Avokati i Shtetit përfiton shpërblim të posaçëm për çështje gjyqësore të veçanta, të vështira, me interes të madh ekonomik të financuar për Republikën e Shqipërisë” dhe jam absolutisht dakord, sepse mund të fitosh çështje të mëdha dhe rast pas rasti qeveria duhet të japë shpërblim, duhet të paguajç. Më vjen keq që Ministria e financave bie dakord me këto shifra, sepse po ranë ata dakord, unë një votë jap, nuk kam se çfarë të bëj dhe nuk e ndryshoj dot.

Kryetar, kur shikoj pagën e Avokatit të Popullit, i cili e ka 267615 mijë lekë, them: “Hallall, Avokatit të Shtetit që të marrë 2 milionë”. Kur shikoj pagën e Avokatit të Popullit, që është e barazuar me pagën e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, që kalon ose jo vetingun, dhe do të marrë 267.615 lekë në muaj, atëherë paga e Avokatit të Shtetit, i cili mendoj se do të bëjë një punë të jashtëzakonshme për të fituar çështjet e shtetit tim, ku do të më përfaqësojë edhe mua, është shumë relativisht e vogël në raport me pagën e Avokatit të Popullit, e cila, pa dashur të fyej askënd, thjesht bën disa rekomandime në bazë të ligjit për problematikën që ka në Shqipëri, që trajtohet në ministritë e caktuara: ti, kujdes këtë, kujdes atë, pra jep disa rekomandime, vjen raportin këtu dhe përsëri do të marrë 2 milionë e 600 mijë.

*(Kryetari i komisionit flet pa mikrofon.)*

Çfarë dua të them me këtë? I bëra të dyja këto diskutime për të parë se në çfarë kushtesh jemi, në çfarë derexheje kemi arritur ne. Këtu kam më shumë vërejtje për Ministrinë e Financave, pse kemi këtë disnivel të pagave në institucione, të cilat janë të përafërta, por nuk vlerësohen njësoj apo kanë vlerësime politike më shumë sesa disa institucione, që varen dhe votohen nga ne, por ne jemi gjithnjë dorëlëshuar kur vjen puna për ta dhe jemi dorështrënguar ose publiku ka perceptimin sikur deputetët bëjnë namin.

Jo, mor, jo, namin e bëjnë të gjitha këto agjenci, të gjithë këta drejtorë dhe të gjithë këta njerëz, të cilët unë do t'i them një për një të enjten në parlament, kur të diskutojmë për projektbuxhetin, që marrin pagë dhe, më lejoni t'jua u them sot, për të hequr çdo kuriozitet për deputetët e mi të Komisionit të Ligjeve.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Bën vaki, për shembull, që kur diskutoj unë, është mirë të na dëgjojë edhe Adnori që është atje, që të mos bëjë më gabime, kupton?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E dini si është piramida e pagës, sipas buxhetit? Në fakt, duhet të jetë kështu: i pari është Presidenti, kryetari i shtetit; pastaj vijnë ekzekutivi, pushteti legjislativ dhe pushteti gjyqësor. Kjo duhet të jetë piramida e pagave, se miratojmë një nen 12 në projektbuxhet dhe themi se paga e Presidentit duhet të jetë kaq; e miraton çdo buxhet i çdo vendi europian.

E dini si do të jetë pas 1 janarit të vitit 2019? Do të jetë piramidë...

Keni parë piramidë të ulur përmbys? Ja, do të jetë kështu!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Do të jetë pushteti gjyqësor në fillim, pastaj disa institucione të pavarura dhe agjenci shtetërore, më tej do të vijë Presidenti i Republikës, ekzekutivi dhe legjislativi; piramida do të jetë përmbys. Kështu do të jetë nga 1 janari. Këtë do të bëjë Ministria e Financave.

*(Kryetari i komisionit lë sallën.)*

Në ligj më kërkon të miratoj këtë. Unë ta miratoj këtë, por ti në praktikë, nga 1 janari i vitit 2019, do të bësh këtë tjetrën.

Këto dy tabela që ju tregova tani do t'i analizoj një për një në diskutimin tim duke përfituar, meqenëse përdora fjalën e Adnorit, të më lërë kohë edhe Adnori dhjetëminutëshin e tij, që të flas dhjetë minuta dhe të jap një argumentim për të gjitha këto institucione.

Prandaj i bëra të dyja këto diskutime, zonja sekretare (meqenëse po drejtoni ju tani, se kryetari u largua), për të treguar se edhe statuset bëjmë gabim që i trajtojmë në këtë mënyrë, sepse duhen trajtuar të gjitha bashkë. Por kur shikoj edhe pagën e Avokates së Popullit, në raport me Avokatin e Shtetit, them se avokati i Shtetit e meriton, pasi do të më zgjidhë të paktën



disa probleme të shtetit tim, do të fitoj disa çështje, ndërsa me Avokatin e Popullit nuk zgjidh gjë, sepse vetëm rekomandime jep: shkruan, rekomandon e kështu me radhë.

*(Deputeti Shameti flet pa mikrofon.)*

Ky është diskutimi im.

Edhe një herë, ju lutem, se nuk e kam personale!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Se mos e kuptoni personale, por nuk kam asgjë personale. Ju e shikoni që jam shumë i përgatitur, e kam parimore, madje e kam edhe për Kryeministrin tim; e kam edhe për Kryetarin e Kuvendit tim!

Shteti ka tre figura: Kryetari i Shtetit, Kryetari i Kuvendit dhe Kryeministri.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Tani, a shkon që të marrë më shumë para drejtori i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, i cili merr 3 milionë e 200 mijë, pra më shumë se Presidenti, më shumë se Kryeministri?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, mor, ta them që ta dish ti, që të më japësh edhe kohën tënde, se mund të më shkojë tridhjetë minuta!

*(Ilaritet në sallë)*

A shkon të marrë më shumë para drejtori i Përgjithshëm i AMF-së, Avokati e të tjerët me radhë? Nuk shkon!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

A shkon që ta marrë një fashë prej 800 gjyqtarësh e prokurorësh? Nuk shkon, madje kjo nuk shkon fare!

Nga kjo pikëpamje, prandaj them se ne bëjmë gabim që i trajtojmë statutet në ligje të veçanta, ligjet organike duhet të trajtohen si ligje për funksionimin e një pushteti të caktuar, për rregullat dhe funksionimin e tyre, por jo për statutet e tyre. Po u morëm me statutet e tyre, absolutisht, do të lëmë pjesën kryesore, pjesën më interesante të projektligjit, dhe do të merremi me ditët e pushimit, me pagat, me shpërblimet, me ruajtjen e vendit të punës për tre vjet e të tjera me radhë. Pse ky është thelbi dhe logjika e projektligjit në fjalë “Për Avokatin e Shtetit”? Jo, nuk është ky qëllimi pse ne e ndryshojmë ligjin e Avokatit të Shtetit; është tjetër gjë! Këto janë privilegje, që mund të trajtohen në lidhje dhe në rend të caktuar.

*(Kryetari i komisionit kthehet në sallë.)*

Humbët një rast shumë të mirë, zoti kryetar, sepse nga i gjithë ky diskutim përfitova dhjetë minuta kohë të zotit Shameti në diskutim!

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Ju kërkoj ndjesë, zoti Fino!

Po, zonja Bushka.

**Klotilda Bushka** – Unë mendoj se me diskutimin e zotit Fino jemi të gjithë dakord.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kjo është një çështje, për të cilën në kuptimin parimor dhe për sa i takon mënyrës se si në Shqipëri duhet të rikonceptohet tërësisht sistemi i piramidës së pagave, duhet të punohet patjetër dhe të shkohet drejt një zgjidhjeje që të unifikohet.

Në lidhje me rastin konkret, po i japim status Avokaturës së Shtetit, si një institucion, i cili është pjesë e arritjes së atyre qëllimeve që i kemi vënë vetes me reformën në drejtësi. Pa statusin, pa pagën si kjo, ky projektligj nuk ka më vlerën që kërkon reforma në drejtësi. Prandaj unë ju kërkoj që ne ta miratojmë dhe, në rishikimin që do t'u bëni skemave të pagave dhe mënyrës se si do të funksionojë piramida e pagave në Shqipëri, rregullojeni edhe këtë çështje. Sepse tani po thoni: meqenëse kemi bërë 99 gabime, ta mbyllim këtu, në mënyrë që ta rikuperojmë atë gabim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ato 99 gabime duhen rregulluar me një reformë rrënjësore. Kjo është një çështje, që na vjen si detyrë nga reforma në drejtësi dhe, nëse nuk e miratojmë kështu siç është propozuar, më vjen keq t'ju them, por institucioni i Avokaturës së Shtetit nuk do të funksionojë ashtu siç edhe ne së bashku e kemi kërkuar dhe e kemi miratuar jo vetëm me Kushtetutën dhe me reformën, por me të gjitha ligjet e tjera të reformës në drejtësi.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Bushka!

Unë kam një pyetje, në fakt, para se ta hedhim në votim.

Për nga mënyra si është formuluar neni 24, që ndryshon nenin 27, nga pikëpamja e teknikës legjislativë, a është korrekte vendosja e koeficienteve në ligj?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Është korrekte? Pra, ka praktikë. Në rregull.

Si mendon Ministria e Financave?

**Gelardina Prodani** – Ministria e Financave nuk është dakord që koeficientët të vendosen në këtë ligj, por duhen futur te hierarkia e pagave.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të gjithë koeficientët duhet të rrinë atje.

**Ulsi Manja** – Pra, ju kundërshtoni...

**Gelardina Prodani** – Nuk shprehemi dakord.

**Ulsi Manja** – ...vetëm vendosjen e koeficientëve në ligj.

**Gelardina Prodani** – Jo në këtë ligj.

**Ulsi Manja** – Po në parim a jeni dakord me skemën që propozohet neni 24?

**Gelardina Prodani** – Skema është e dakordësuar, por jo në këtë ligj.

**Ulsi Manja** – Atëherë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, nuk ka rëndësi!

Meqenëse në parim është e dakordësuar si skemë page, çështja e vendosjes së koeficientëve...

**Bashkim Fino** – Po këta të EURALIUS-it ç' mendim kanë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Të lutem!

*(Deputeti Fino flet pa mikrofon.)*

Dakord janë edhe ata, sepse është dakordësuar ligji.

*(Deputeti Fino flet pa mikrofon.)*

Ju lutem, zoti Fino!

**Bashkim Fino** – Pse, mor, burrë, kam të drejtë të bëj pyetje, apo jo?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Pra, Ministria e Financave është dakord në parim me nenin 24 lidhur me skemën e pagave, por kërkon që koeficientët të mos jenë të fiksuar në ligj.

**Gelardina Prodani** – Jemi të mendimit që tatimi financiar të dedikohet te hierarkia e pagave.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Pra, ju kërkoni që të bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave...

**Gelardina Prodani** – Po, ashtu sikurse...

**Ulsi Manja** – ...dhe jo e fiksuar në ligj.

**Gelardina Prodani** – Ky është parimor. Ministria e Financave e ndjek këtë procedurë me të gjitha.

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

Jo më kot e bëra pyetjen nga pikëpamja e teknikës legjislativë nëse kemi ligje të tjera, ku koeficientët e pagës kanë qenë të fiksuar në ligj, por kolegët më thonë se kemi ligje të tjera, ku kemi operuar me të njëjtin standard të teknikës legjislativë.

Në këto kushte, e hedhim në votim nenin 24, sipas variantit të parashtruar në tekstin integral.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Do të votojmë nenin 24, që ndryshon nenin 27.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Një nen është. Kush është pro nenit 24?

*(Diskutime në sallë)*

Ju lutem, ngrini duart, se...!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zonja Hysi, dorën!

**Vasilika Hysi** – Duhet patjetër?

**Ulsi Manja** – Jo, moj, patjetër jo, por dua të numëroj votat pro!

Një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë vota pro. Kundër? Një votë kundër. Abstenim? Një votë abstenim. Një deputet nuk mori pjesë në votim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zonja Hysi nuk mori pjesë në votim.

Atëherë, miratohet neni 24.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, nuk e ngriti dorën për votë pro, sepse unë nuk e numërova!

Nuk pashë dorë pro.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kur thuhet: “ngrini dorën”, dora ngrihet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Neni 25.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Patjetër, sipas Rregullores, keni të drejtën për ta shpjeguar votën.

**Bashkim Fino** – Votova kundër dhe do të vazhdoj të jem derisa të bëj shokë dhe shoqe me vete, madje ishallah bëj me shumicë.

Në mënyrë agresive do të vazhdoj kundër, sepse jam dakord me mendimin e Ministrisë së Financave, që këto shifra nuk duhet të trajtohen në ligjet organike, por në ligjin bazë të pagave në Republikën e Shqipërisë. Ai është ligji bazë i miratuar. Hajdeni ta bëjmë edhe atë me tre të pestat; hajdeni ta bëjmë me shumicë të cilësuar edhe atë ligj!

Të bëhet një tabelë dhe një piramidë e re pagash në Republikën e Shqipërisë, duke filluar nga kryetari i shtetit dhe të gjitha institucionet me radhë, të marrin të gjithë atë që

meritojnë politikisht, financiarisht, po të doni moralisht dhe ta miratojmë, të dakordësuar me votim me tre të pestat, që të mos ketë njeri të drejtë ta ndryshojë më tabelën e pagave!

Me këto ligje që ne po kalojmë, ku u bëjmë nder individëve apo grupeve të ndryshme, bëjmë shumë gabim, sepse shkatërrojnë financat. Disiplina financiare është më e rëndësishme se çdo reformë tjetër; pa atë nuk mund të ecet përpara.

Edhe reforma në drejtësi kërkon para, kërkon disiplinë financiare, por nuk mundet dot, sepse ajo ka qenë në qendër të themelit. Hajde, paguajmë gjyqtarët dhe prokurorët që do të dalin të pastër dhe që janë të ndershëm, sepse kalojnë vetingun, të cilët nesër do të bëjnë drejtësi për qytetarët shqiptarë!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Shumë bukur dhe le ta meritojnë atë pagë!

Nuk jam kundër tyre për pagën që do të marrin, sepse do të na japin një drejtësi të pastër nesër për të gjithë shqiptarët, por jo nëpërmjet mënyrës si i bëjmë ne ligjet, duke i kaluar ne ligjet organike! Jo, kjo bëhet vetëm me ligjin organik të pagave në Republikën e Shqipërisë!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Prandaj votova kundër dhe jam energjik në këtë gjë. E përsëris, nuk kam gjë me individë të caktuar, por e kam parimore, e kam në tërësi me të gjitha institucionet që fitojnë padrejtësisht duke e sjellë ligjin këtu!

Ore, zotërinj, ju e sillni ligjin këtu për funksionet e ligjit ekzistues, ligjit që ke ti vetë: si do të funksionosh ti si avokat; si Avokat i Popullit; si organ i pushtetit vendor!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk e ke ligjin këtu për të marrë benefite të caktuara dhe për të marrë paga! Ky është gabimi që po bëni ju, zoti kryetar, dhe që e votuat në mënyrë të njëanshme pro.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

Në parim ishim të gjithë dakord me ju, por...

**Bashkim Fino** – Me cilat?

**Ulsi Manja** – ...kjo duhet të rregullohet te ligji i pagave.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë vazhdoj t'i qëndroj idesë, të cilën e manifestova edhe me votë së bashku me shumicën e kolegëve, që, për të thithur kapacitete tek Avokatura e Shtetit, do të duhet t'i mbështesim me këtë nivel pagash që ne sapo miratuam te neni 24. Se, në fund të fundit, çfarë është Avokatura e Shtetit? Nëse kemi prokurorinë, që është avokati i interesit publik për çështjet penale, Avokatura e Shtetit mbron interesin publik për sa u përket çështjeve civile.

Nëse ne kemi objeksione ose vërejtje për mënyrën se si është trajtuar mbrojtja e shtetit qoftë nga gjykatat shqiptare, qoftë në Strasburg, kjo ka ardhur edhe për shkak të mospërfaqësimit dinjitoz të Avokaturës së Shtetit në këto institucione.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë nuk e di nëse ka ose jo një studim se në sa çështje ka fituar shteti në Strasburg apo në gjykatat shqiptare dhe në sa ka humbur, ama jam i bindur që në shumicën dërrmuese të rasteve shteti do të ketë humbur përballë individëve.

Shpresoj dhe besoj që ndoshta pas miratimit të këtij niveli pagash, që ne sapo miratuam te neni 24...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

...edhe në avokaturën e përgjithshme të shtetit të thithim kapacitetet e duhura juridike për të bërë një mbrojtje dinjitoze të shtetit.

Unë jam shumë dakord me atë që tha zoti Fino, sepse kemi një zhbalancim të sistemit të pagave në Shqipëri, që kjo nuk mund të rregullohet sot dhe nëpërmjet këtij ligji që po diskutojmë, por ka nevojë ndoshta për ndërhyrje te ligji “Për sistemin e pagave në Republikën e Shqipërisë”, ku të respektohet neni 12 i ligjit “Për buxhetin e shtetit”, për të cilin debatuar javën që kaloi dhe që ka si pagë referencë hierarkinë e pagës së Presidentit të Republikës.

Gjithsesi, faleminderit!

Vazhdojmë me nenin 25 “Krijimi i fondit dhe shpërblimi i avokatëve të Shtetit”. Ka komente për këtë nen?

*(Deputeti Fino flet pa mikrofon.)*

**Bashkim Fino** – ...po bëj të kundërtën.

**Ulsi Manja** – Keni propozim për ndryshim për nenin 25?

**Bashkim Fino** – Po, të mos jetë pagë.

**Ulsi Manja** – Hedhim në votim propozimin e zotit...

**Bashkim Fino** – Jo, mor jo...!

**Ulsi Manja** – Ju lutem, shtypeni mikrofonin!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nëse keni propozim konkret, çfarë problemi ka?

**Bashkim Fino** – Po pra, kam.

*(Deputeti Fino flet pa mikrofon.)*

**Adnor Shameti** – Me mikrofon, zoti Fino!

**Ulsi Manja** – E bëri pa mikrofon.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Adnor Shameti** – Jo, nuk quhet!

**Ulsi Manja** – Kush është dakord me nenin 25 të ligjit, që ndryshon nenin 28? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 25.

Kalojmë te neni 26. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me nenin 27. Pas nenit 32, shtohet neni 32/1 me këtë përmbajtje: “Komisioni i disiplinës”. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 27.

Kalojmë te neni 28, që është dispozitë kalimtare. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 28.

Kalojmë te neni 29 “Aktet nënligjore”. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 30 “Hyrja në fuqi e ligjit”. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hedhim në votim në tërësi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit””, sipas variantit integral, që ne sapo e miratuam nen për nen, dhe sipas listimit të ri që do të bëjnë këshilltarët në lidhje me nenet e shtuara të projektligjit.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe në tërësi projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit””, sipas numërtimit të ri të neneve që do të bëhet nga këshilltarët dhe sipas tekstit integral.

Shumë faleminderit, të nderuar kolegë, për këtë projektligj dhe për votën tuaj! Projektligji, së bashku me raportin përkatës, të bëhet gati për në seancën plenare të datës 22.

Gjithashtu, dua të falënderoj zonjën Prodani, zotin Metani, zotin Teta dhe përfaqësuesit e EURALIUS-it për prezencën tuaj në komision! Ditë të mbarë!

**Adnor Shameti** – Suksese në misionin tuaj fisnik!



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 20.11.2018, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Njoftimi mbi raportin e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të Ligjit Nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” për procesin e ngritjes së Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Sistemin e Drejtësisë (KPESD) në zbatim të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë””.

**Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Xhemal Qefalia.

**Mungojnë:**

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka dhe Tom Doshi.



**Ulsi Manja** – Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës, në njoftimin e raportit të Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” për procesin e ngritjes së Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Sistemin e Drejtësisë, në zbatim të ligjit nr. 115 të vitit 2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Të nderuar kolegë, siç jeni në dijeni, Komisioni i Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” ka prodhuar raportin e parë si komision për Komisionin e Ligjeve, ndaj unë kam detyrimin ligjor që t’ua bëj të ditur të gjithë kolegëve të Komisionit të Ligjeve, si dhe opinionit publik. Është një raport i këtij komisioni lidhur me procesin e ngritjes së Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Sistemin e Drejtësisë, në zbatim të ligjit nr. 115 të vitit 2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Duke qenë se në datën 15.11.2018, sipas Kushtetutës dhe ligjit përkatës, është hapur procesi i hedhjes së shortit për anëtarë në Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, ky komision ka prodhuar këtë raport dhe i sugjeron Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të vlerësojë mbajtjen në konsideratë të këtij raporti edhe në rastin e komunikimit ndërinstitucional me organet e ngarkuara nga Kushtetuta dhe ligji për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Sistemin e Drejtësisë për vitin 2019.

Krijimi i Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Sistemin e Drejtësisë do të bënte plotësisht të mundur vijimin me sukses të reformës në sistemin e drejtësisë për sa kohë që krijimi i këtij këshilli do t’u jepte udhë, midis të tjerave: 1. Përzgjedhjes së kandidatave për Gjykatën Kushtetuese, dhe 2. Vijimit të procedurave për përzgjedhjen dhe emërimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

*(Diskutime në sallë)*

Në vijim edhe të këtij komunikimi me Komisionin e Pavarur, por edhe me institucionet e tjera, unë sjell në vëmendje të kolegëve që Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, sipas Kushtetutës dhe ligjit, është i detyruar të marrë në konsideratë gjetjet dhe vlerësimet e këtij raporti vetëm në rast se Presidenti i Republikës nuk e ushtron këtë kompetencë kushtetuese dhe ligjore.

Pra, ndërmjet datave 5 dhe 10 dhjetor, Kuvendi i Shqipërisë është i detyruar nga Kushtetuta dhe ligji të marrë në konsideratë të gjitha vlerësimet dhe gjetjet e këtij raporti.

Do t’u kërkoja këshilltarëve që ky raport dhe vendimi përkatës i komisionit t’u bëhet i ditur, pra t’u vihet në dispozicion të gjithë kolegëve të këtij komisioni, përfshirë edhe kolegët

e opozitës që mungojnë në këtë komision, si dhe të bëhet publike edhe në faqen zyrtare të Kuvendit.

Shumë faleminderit dhe...

**Bashkim Fino** – Meqenëse ikën mediet...

**Ulsi Manja** – ...me këtë njoftim e mbyllim këtu mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme!

**Bashkim Fino** – Zoti kryetar...

**Ulsi Manja** – Mbledhja e radhës do t'ju njoftohet nga sekretaria e komisionit.

Shumë faleminderit!

*(Diskutime në sallë)*

## **MBYLLET MBLEDHJA**

